

---

**VENDIMI I KËSHILLIT 2008/206/ÇBD, DATË 3 MARS 2008, "PËR PËRCAKTIMIN E 1-BENZILPIPERAZINËS (BZP) SI NJË SUBSTANCË E RE PSIKOAKTIVE E CILA DUHET TË BËHET OBJEKT I MASAVE TË KONTROLLIT DHE DISPOZITAVE PENALE"**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian,

Duke pasur parasysh Vendimin e Këshillit 2005/387/ÇBD, datë 10 maj 2005, "Për shkëmbimin e informacionit, vlerësimin e rrezikut dhe kontrollin e substancave të reja psikoaktive"<sup>1</sup> dhe në veçanti nenin 8, paragrafi 3 të tij,

Duke pasur parasysh nismën e Komisionit,

Pas këshillimit me Parlamentin Evropian,

Meqë:

1. Në një seancë të posaçme të Komitetit të zgjeruar Shkencor të Qendrës Evropiane të Monitorimit për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave u hartua një raport i vlerësimit të rrezikut për 1-benzilpiperazinën (BZP), në përputhje me Vendimin 2005/387/ÇBD, i cili iu dorëzua Këshillit dhe Komisionit më 31 maj 2007.

2. BZP është një substancë sintetike. Ajo u raportua për herë të parë në Bashkimin Evropian në 1999. Sikurse amfetamina dhe metamfetamina, BZP është një stimulant i sistemit nervor qendror, por me fuqi shumë më të ulët (afërisht sa 10% i fuqisë së d-amfetaminës). Polimorfizmat gjenetikë në sistemet enzimatike mund të ndikojnë në metabolizmin e BZP-së duke çuar në ndjeshmëri më të gjerë ndërindividuale ndaj efekteve të BZP-së. Ekziston gjithashtu mundësia e ndërveprimit me droga të tjera, por në përgjithësi mungojnë të dhëna farmakokinetike në lidhje me njerëzit.

3. Në disa shtete anëtare, BZP është ligjërisht e disponueshme në shitje nga furnizuesit me pakicë të kimikateve; për qëllime rekreacioni, BZP shitet në formën e tabletave dhe kapsulave nëpërmjet faqeve të internetit ose, në disa shtete anëtare, në dyqane të posaçme të shitjes së substancave/bimëve psikoaktive. Në tregun e drogave të paligjshme, BZP mund të shitet/blihet edhe në formën e ekstazisë, e cila është një drogë e njohur gjerësisht.

4. Trembëdhjetë shtete anëtare dhe një shtet i tretë (Norvegjia) kanë raportuar raste të sekuestrimit të BZP-së në formën e pluhurit, kapsulave ose tabletave, të cilat variojnë nga një kapsulë/tabletë deri në 64 900 tableta. Informacioni që mund të sugjerojë sintezë, përpunim apo shpërndarje masive të BZP-së dhe përfshirjen e krimit të organizuar, është i pakët.

5. BZP nuk ka asnjë vlerë të vërtetuar e të njohur mjekësore; në Bashkimin Evropian nuk ka asnjë produkt mjekësor të licencuar e të njohur me përmbajtje BZP.

6. BZP nuk është dhe nuk ka qenë objekt vlerësimi nga sistemi i OKB-së. Në pesë shtete anëtare, BZP i nënshtrohet masave të kontrollit dhe sanksioneve penale të parashikuara në legjislacionin e tyre në kuadër të detyrimeve sipas Konventave të vitit 1961 ose 1971 të Kombeve të Bashkuara. Dy shtete anëtare e kanë bërë BZP-në objekt të masave të kontrollit në kuadër të legjislacionit të tyre për barnat.

7. Autopsia pas vdekjes ka zbuluar praninë e BZP-së. Megjithatë, nuk dihet se deri në çfarë mase BZM është shkaktare e vdekjes, duke qenë se në të gjitha rastet kanë qenë përfshirë edhe substanca ose rrethana të tjera.

8. Raporti i vlerësimit të rrezikut mbi BZP-në nxori në pah mungesën e të dhënave shkencore përfundimtare në lidhje me rreziqet e përgjithshme të BZP-së. Megjithatë, për shkak të vetive stimuluese, rrezikut ndaj shëndetit, mungesës së përfitimeve mjekësore dhe për të respektuar parimin e parandalimit, nevojitet kontrolli i BZP-së, por masat e kontrollit duhet të jenë të përshtatshme për rreziqet relativisht të ulëta të substancës.

9. Vendosja nën kontroll e 1-benzilpiperazinës mund të ndihmojë që të shmangen problemet në bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet agjencive ligjzbatuese dhe shërbimeve gjyqësore,

VENDOSI SI MË POSHTË:

Neni 1

Shtetet anëtare duhet të marrin masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, për ta bërë 1-benzilpiperazinën (e njohur edhe si 1-benzil-1,4-diazacikloheksan, N-benzilpiperazinë ose - në terma më të përgjithshëm, si benzilpiperazinë ose BZP) objekt të masave të kontrollit në mënyrë proporcionale me rreziqet e substancës dhe të sanksioneve penale të parashikuara në legjislacionin e tyre në përmbushje të detyrimeve sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për lëndët psikotrope të vitit 1971.

Neni 2

Ky vendim botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Ai hyn në fuqi një ditë pas botimit.

Nënshkruar në Bruksel, më 3 mars 2008.

Për Këshillin

Presidenti

## J. PODOBNIK

---

1. *Gazeta Zyrtare L 127, 20.5.2005, f. 32.*

---